



KRAHASIM I STILEVE FUNKSIONALE TË GJUHËS SHQIPE ME ATO TË GJUHËS ANGLEZEⁱ

Anejda Rragamiⁱⁱ

PhD. Candidate,
Faculty of Foreign Languages,
University of Tirana, Albania

Abstract:

Ky punim bëhet në kuadër të fushes së Stilistikës dhe përqendrohet në krahasimin e stileve funksionale në gjuhën angleze dhe shqipe. Pra, objekti i punimit janë stilet funksionale në gjuhën angleze dhe shqipe. Qëllimi i studimit është gjetja e ngjashmërive dhe dallimeve që kanë stilet funksionale në gjuhën shqipe dhe angleze. Metoda e përdorur në këtë studim është ajo krahasuese. Ky punim ndahet në katër pjesë. Në pjesën e parë jepet një vështrim i përgjithshëm për stilistikën dhe stilen funksionale. Më pas në pjesën e dytë jepen karakteristikat e stileve funksionale në gjuhën angleze në kuadrin e klasifikimeve të ndryshme funksioneve dhe karakteristikave të tyre. Në pjesën e tretë jepen karakteristikat e stileve funksionale në gjuhën shqipe në kuadrin e klasifikimeve të ndryshme funksioneve dhe karakteristikave të tyre dhe në pjesën e fundit jepen përfundimet në lidhje me stilet funksionale në gjuhën angleze dhe shqipe duke nxjerrë ngjashmëritë dhe dallimet. Ky punim është bazuar në klasifikimin e I. Galperinit për stilet funksionale në gjuhën anleze dhe në klasifikimin e Xh. Lloshit për stilet funksionale në gjuhën shqipe.

Fjalet kyce: stilistika, stilet funksionale, gjuha shqipe, gjuha nagleze, ngjashmeri, dallime

Abstract:

This work is done within the subject of stylistics and focuses on the comparison of functional styles in English and Albanian. So the work object is functional styles in English and Albanian. The purpose of the study is to find the similarities and differences that have functional styles in Albanian and English. The method used in this study is the comparative one. This work is divided into four parts. The first part gives a general look at the stylistics and functional style. Then, in the second part, the characteristics of functional English styles

ⁱ COMPARISON OF FUNCTIONAL STYLES OF ALBANIAN AND ENGLISH LANGUAGES

ⁱⁱ Correspondence: email anejda_01@hotmail.com

are given in the context of different classifications of their functions and characteristics. In the third part, the characteristics of functional styles in Albanian are given in the context of different classifications of their functions and characteristics. Finally, the results are given in conjunction with functional styles in English and Albanian by drawing similarities and differences. This paper is based on the classification of I. Galperini for functional styles in English and in the classification of Xh. Typing for functional styles in Albanian.

Key words: stylistics, functional styles, Albanian language, English language, differences, similarities

1. Vështrim i përgjithshëm i stilistikës dhe stileve funksionale

Stilistika është disiplinë e veçantë e cila merret me studimin e stilit dhe të figurave stilistike. Fjala stil vjen nga fjala latine *stilus*, që në lashtësi kishte kuptimin e një lapsi të metaltë që shërbente për të shkruar në tabelëzat prej dylli. Më vonë kjo fjalë mori kuptime të ndryshme. Në fushën e letërsisë stili është mënyrë e të shkruarit ose mënyrë e të shprehurit e ndonjë individi, qoftë të një bashkësie ose të një periudhe. Përcaktimi i stilit në periudhat e ndryshme historike ka qenë i ndryshëm; ai është veçanti e çdo veprimtarie që kryhet në mënyrë të perceptueshme dhe në mënyrë të ndryshme, p.sh. stili i veprës, stili i punës, stili i notit, stili i jetës – mënyra e jetës etj.; veçanti e veprave të ndryshme të artit, e ekzekutimit të tyre dhe e mënyrës artistike të autorëve: stili në arkitekturë, stili i epokës, veçanti e të shprehurit në gjuhë etj.

Sipas mendimit më të përhapur, stili është veçanti e autorit ose shmangie nga gjuha e zakonshme. Kjo shmangie shihet në çdo gjë, duke filluar nga ndërtimi i fjalisë e deri te përdorimi i fjalëve dhe i tingujve të veçantë në të (fjali). Por nga ana tjetër stilistika ka si objekt të saj edhe stilet funksionale.

1.1. Çfarë janë stilet funksionale?

Gjuha standarde, si forma më e lartë që i përpunon dhe i përsos mjetet e marrëveshjes e të shprehjes gjuhësore, përdoret në të gjitha fushat e veprimtarisë shoqërore, porse secila fushë i zgjedh, i përpunon e i përdor këto mjete sipas kërkesave të veta. *Sistemi i mjeteve gjuhësore, të zgjedhura e të përdorura në përshtatje me përmbajtjen e kërkesat e një fushe të caktuar të veprimtarisë shoqërore, përbën stilin funksional.* Shkurt, stili funksional është trajta që merr standardi për të përmbushur kërkesat e shprehjes gjuhësore në një fushë të caktuar të veprimtarisë shoqërore.

Dallimi i stileve funksionale nga njëri-tjetri ndonjëher përbën një problem për këto arsye:

1. Stilet funksionale janë të ndërlidhura me njëra-tjetrën dhe mbivendosen;
2. Stilet unksionale ndryshojnë me kalimin e kohës;
3. Nocioni i stilit funksional është i përafërt me atë të xhanreve

2. Klasifikimi i stileve funksionale në gjuhën angleze

Ekzistojnë disa klasifikime të stileve funksionale në gjuhën angleze. Ndër to më të njohurit janë:

1. Klasifikimi i I.R. Galperinit,
2. Klasifikimi i I. Arnoldit dhe
3. Klasifikimi i J. Skrebnevit

I.R. Galperin i ndan stilet funksionale në:ⁱⁱⁱ

- I. Stili shkencor
- II. Stili i dokumentave zyrtare
- III. Stili publicistik
 - Oratoria dhe fjalimet
 - Eseja
 - Artikujt
- IV. Stili gazetaresk
 - Lajmet shkurt
 - Titujt e gazetave
 - Editorialet
 - Reklamat dhe njoftimet
- V. Stili letrar (letrave të bukura)
 - Poezia
 - Proza
 - Drama

Siç shihet Galberin nuk e përmend fare varianitin e folur të gjuhës. Sipas tij ligjërimi bisedor nuk lejon përzgjedhjen e kujdesshme gjuhësore dhe për rrjedhim folësi nuk shpreh asnjë qëllim stilistikor.

Irina Arnoldi dallon këto stile funksionale:^{iv}

I. Stili letrar/libror

- Stili shkencor
- Stili i dokumentave zyrtarë
- Stili i veprove të botuara

ⁱⁱⁱ Galperin I.R., (2004) *Practical Stylistic of English*.

^{iv} Arnold V.I., (1986) *The English word*. By Moscow: Vyssaja Skola

- Stili i gojëtarisë
- Stili poetik

II. Stili bisedor

- Stili bisedor letrar
- Stili bisedor familjar
- Stili bisedor i shkujdesur

Irina Arnoldi në klasifikimin e saj nuk përmend fare stilin gazetaresk dhe për këtë arsye ky klasifikim ka qenë disi i kundërshtuar nga studjuesit e tjerë. Por nga ana tjetër ajo ishte e para që prezantoi stilin neutral i cili, sipas saj, krijon sfondin standart për stilet e tjera. Në klasifikimin e saj ajo u bazua në faktorë të ndryshëm shoqërorë dhe jashtëgjuhësorë të cilët ndikojnë në zgjedhjen e një gjuhe të caktuar me qëllim për të përçuar një mesazh të caktuar.

Ndërsa J. Skrebnev dallon këto stile funksionale:^v

I. Stili letrar ose libror

- Stili publicistik
- Stili shkencor
- Stili i dokumentave zyrtare

II. Stili i lirë ose bisedor

- Stili i lirë letrar
- Stili bisedor

Skrebnev i referohet stileve funksionale si nëngjuhë, pasi i konsideron ato si produkte të pafundme të situatave komunikuese si nëngjuhë. Ai mendon se çdo akt i të folurit është nëngjuhë.

Më poshtë do të analizojmë karakteristikat e stileve funksionale. Për bazë në këtë punim janë marrë stilet funksionale të Galperinit pasi ai jep dhe një përshkrim më të detajuar të tyre.

2.1 Stili shkencor^{vi}

Funksioni - Dhënia e hipotezave dhe krijimi i konceteve të reja.

Karakteristikat:


- Gjuhë objektive, e saktë, pa ngjyrimë emocionale; fjalët përdoren në kuptimin e tyre të parë
- Përdorimi i termave dhe fjalëve të një niveli të caktuar
- Forma e të shprehur është e papersonalizuara dhe e përgjithësuar; kjo gje pasqyrohet edhe në përzgjedhjen gramatikore dhe sintaksore

^v Skrebnev Y.M., (2003) *Fundamentals of English Stylistics.*, By AST

^{vi} Galperin I.R., (2004) *Practical Stylistic of English.*

- Vijë e logjikshme e të shprehurit
- Ka një sistem më të zhvilluar të lidhëzave
- Llojet e fjalive janë postulate, argumentuese dhe formuluese
- Vihet re përdorimi i citimeve dhe referencave

2.2 Stili i dokumentave zyrtare^{vii}




Funksioni - Përcakton kushtet që lidhin dy palë në një sipërmarrje dhe synon arritjen e marrëveshjes

Karakteristikat:

- Përdorimi i fjalëve me kuptiin e tyre të parë, përdorimi i një sistemi të caktuar klishes, termave dhe shprehjeve
- Përdorimi i nomenklaturave terminologjike
- Përdorimi i fjalëve pa ngjyrimë emocinale
- Forma të veçanta adresimi, hapje dhe mbyllje të dokumentave
- Përdorimi i shkurtimeve, dhe simboleve konvencionale

2.3 Stili i publicistikës

Stili i publicistikës ka formën e tij të folur dhe të shkruar. Respektivisht oratoria dhe fjalimet, si dhe esetë.



Funksioni – Bindja

Karakteristikat e stilit:

- Kontakt i drejtëpërdrejtë me audiencën (use of *you, your, we, our*)
- Përdorimi i vetës së parë njëjës për të justifikuar afrimitetin që tregohet në lidhje me problemin.
- Kombinimi i argumentimit logjik dhe atij emocional si pasojë e argumentimit logjik

^{vii} Galperin I.R., (2004) *Practical Stylistic of English*.

- Struktura sintetike, koherente dhe logjike
- Sistem i zgjeruar ilidhëzave (*hence, inasmuch, thence, forward, therefore*)
- Perifrazimi i kujdesshëm
- Shkurtësia në të shprehur
- Përdorimi i fjalëve me kuptim të figurshëm
- Mjete të figurshme stilistikore nuk janë gjithnjë të reja dhe krejt të pastra përse i përket origjinës së tyre dhe kjo e bën paksa të vështirë që të kuptohet mesazhi si duhet nga audienca.


Karakteristikat e nënstilit:

Esetë: Përdorimi i krahasimit dhe metaforës për të mirëprezantuar idetë

Oratoria dhe Fjalimet:

- Kontakt i drejtpërdrejtë me audiencën (*Your worship, Mr. Chairman; you, with your permission, Mind!*)
- Forma të veçanta për hapjen apo mbylljen e një fjalimi (*Ladies and Gentlemen; In the name of God do your duty*)
- Fjalë që shprehin opinionin e vetë folësit (*I'm no idealist to believe firmly in, I'm confident that*)
- Përdorim të gjërë të përsëritjes (leksikore, sinonimike, sintaksore) për tu fokusuar në gjërat më të rëndësishme
- Pyetje të shumta retorike
- Përdorimi i krahasimit dhe metaforës për të mirëprezantuar idetë.
- Lejohet përdorimi i shkurtimeve

2.4 Stili gazetaresk^{viii}



Karakteristikat e fjalorit të këtij stili janë:

- Termat e veçantë politik dhe ekonomik** (p.sh *apartheid, by-election, per capita production*)
- Fjalori politik joterminologjik** (p.sh *public, people, progressive, nation-wide unity*).

^{viii} Galperin I.R., (2004) *Practical Stylistic of English*.

- c) **Klissetë e përdorura në gazeta**, shprehjet stereotip të cilat janë të njohura për lexuesin (*p.sh. vital issue, well-informed sources, overwhelming majority, amid stormy applause*)
- d) **Klissetë** reflektojnë më shumë se çdo gjë tjetër mënyrën e të shprehurit në shkrimin e gazetës. Ato shmangin dykuptimshërinë dhe keqkuptimet. (*p.sh. captains of industry, pillars of society.*)
- e) **Shkurtime** përdoren shumë në kronikat e lajmeve, artikujt apo titujt e gazetave. Kjo shërben për të kursyer kohë dhe vend. (*p.sh. WHO, BBC, UN, PM, NATO, AIDS etj.*)
- f) **Neologjizmat**. Gazetat reagojnë shumë shpejt ndaj çdo zhvillimi të ri në jetën e shoqërisë dhe teknologjisë, dhe nga kjo gjë nuk përjashtohen as neologjizmat. Por duhet përmendur fakti që shumë neologjizma dalin jashtë përdorimit shumë shpejt.

Karakteristikat e stilit:

Sintaksa koncize e paraqitur nëpërmjet llojeve të ndryshme të fjalive:

- Fjali të plota dëftore ("*Allies Now Look to London*")
- Fjali pyetëse ("*Do You Love War?*")
- Pyetje retorike ("*The Worse the Better?*")
- Fjali emërore ("*Gloomy Sunday*")
- Fjali eliptike:
 - Pa folje ndihmëse ("*Initial Report Not Expected Until June*")
 - Pa kryefjalë ("*Stole Luxury Cars by Photos*")
 - Pa kryefjalën dhe një pjesë të kundrinorit ("*Still in Danger*")
 - Fjali me nënrenditje ("*Senate Panel Hears Board of Military Experts Who Favoured Losing Bidder*")

Përdorime të veçanta gramatikore

- Koha e tashme e foljes ("*Queen Opens Hospital Today*")
- Fjali pa nyje ("*Royal Family Quits*")
- Infinitivi që tregon të ardhmen ("*President to visit Austria*")
- Ndërtime të pjesores dhe xherundit që tregojnë kohën e tashme ("*Keeping prices doën*")
- Përdorimi i ligjeratës së drejtë ("*What Oils the Wheels of Industry?*" *Asks James Lowery-Olearch of the Shell-Mex and B.P. Group*)
- Deformimi i një sërë termash ("*Conspirator-in-Chief*")
- Përdorimi i një seti shprehjesh frazeologjike
- Përdorimi i mjeteve stilistikore që prodhojnë një efekt emocional të fortë. ("*And What About Watt*")

3. Lajmet shkurt

Karakteristikat e renditura më lart që kanë të bëjnë me stilin gazetaresk vlejné edhe për nënstilin e lajmeve shkurt por y nënstil ka dhe disa karakteristika të tjera të veçanta.

Funksioni - Informon lexuesin. Përcakton faktet pa dhënë komente

Karakteristikat

- Mungesa e ngjyrimit emocional dhe e individualitetit në të shprehur.
- Fakti dhe steriotipizimi i shprehjes
- Struktura sintaksore të veçanta për shkak se gazetari duhet t'i thotë lajmet sa më shkurt:
 - Përdorimi i fjalive të nënrenditura
 - Ndërtime foljore të caktuar (infinitivi, pjesorja, xherundi)
 - Rendi i fjalëve në fjali
 - Raste komplekse si ajo e fjalisë pa kryefjalë por me infinitiv)
 - Mos respektimi i kohëve të foljes

4. Reklamat dhe Njoftimet

Në gazetarinë moderne angleze njihen dy llojë reklamash dhe njoftimesh:

1. Të klasifikuara dhe
2. Të paklasifikuara.

Në reklamat dhe njoftimet e klasifikuara paraqiten lloje të ndryshme informacioni sipas temës dhe ndahen në seksione të veçanta, si p.sh. (Lindjet, Martesat, Përkujtimoret etj). Ky lloj klasifikimi ka sjellë dhe përdorimin e një sërë modelesh të cilat përdoren nëpër gazeta. Karakteristikat e reklamave dhe njoftimeve të klasifikuara janë:

- Përdorimi deri diku i fjalëve të figurshme, që përmbajnë një farë ngjyrimi emocional me qëllim që të tërheq vëmendjen e lexuesit
- Modeli i përcaktuar, shpesh eliptik
- Pohime në formë telegramësh, pa nyje apo shenja pikësimi.

Ndërsa për sa i përket reklamave dhe njoftimeve të paklasifikuara përdoren një shumëllojshmëri varietetsh të gjuhës, gjë që e bën të pamundur nxjerrjen e karakteristikave të përbashkëta. Vëmendja e lexuesit tërhiqet nëpërmjet mjeteve tipografike, grafike, stilistike, leksikore dhe sintaksore.


5. Artikujt

Funksioni - Ndikimi tek lexuesi nëpërmjet interpretimit të fakteve të ndryshme

Karakteristikat:

- Kombinimi i shtresave të ndryshme të ligjërimit
- Përdorimi i fjalëve me ngjyrim emocional, leksikor dhe strukturor
- Pranohet e folura me fjalë të dialektit, zhargonit, shprehje frazeologjike
- Përdorimi i mjeteve të ndryshme stilistikore, apo fjalë që lidhen drejtpërsëdrejti me kulturën apo traditën e vendit (Wall Street; Downing Street; Fleet Street.)
- Mjete të mirëfillta stilistikore nuk përjashtohen gjithashtu.

I. Stili letrar^{ix}



Funksioni – Estetik dhe njohës

Karakteristikat e stilit:

- Nuk ka teipare të vecanta duke qënë se ky stil nuk është homogjen, përmban stile dhe regjistra të ndryshëm.
- Zgjedhja e mënyrës dhe formës varet nga preferenca e autorit.
- Lloje të ndryshme shprehjesh
- Përdorimi i fjalëve me më shumë se një kuptim

Karakteristikat e gjuhës së poezisë:

- Ritmi dhe rima (aliteracioni, asonaca)
- Përdorimi i figurave të shumta letrare
- Përdorimi i mjeteve sintaksore (inversion, elisat, fragmentarizimi i fjalive etj)
- Përdorimi i fjalëve me ngjyrim emocional

Karakteristikat e gjuhës së prozës:

- Kombinimi i gjuhës së folur me atë të shkruar
- Përdorimi i dy formave të komunikimit (monologut dhe dialogut)

Karakteristikat e gjuhës së dramës:

- Stilizimi i gjuhës: gjuha bisedore i afrohet bisedës reale por përpiqet që të qëndrojë brenda anglishtes standarte
- Përdorimi i një sintakse të thjeshtë, si dhe bëhet shkurtimi i shprehjeve por jo aq i theksuar sa në dialogjet reale
- Bisedat janë pak më të gjata se në bashkëbisedimet normale
- Dialogjet ndonjëherë kanë karakter të ngjashëm me atë të monologjeve

^{ix} Galperin I.R., (2004) *Practical Stylistic of English*.

6. Klasifikimi i stileve funksionale në gjuhën shqipe


Klasifikimi sipas stileve funksionale është një çështje relativisht e ndërlikuar. Pasi stilet funksionale ndërthuren dhe ndryshojnë me kalimin e kohës dhe kanë lidhje të drejtëpërdrejtë me gjinitë letrare. Ato janë gjithashtu në komunikim të vazhdueshëm me njëri-tjetrin dhe kjo e vështirëson me shumë precizimin e kufijve të secilit. Megjithatë brenda secilit stil ekzistojnë tipare të veçanta që e bëjnë njërin stil specifikisht të dallueshëm nga stili tjetër.

6.1 Klasifikimi i stileve sipas Prof.Dr. Xhevat Lloshi

Profesor Xhevat Lloshi në klasifikimin e tij dallon dy ndarje të mëdha të cilat janë: stilet ligjërimore dhe stilet funksionale. Ai e bazon këtë ndarje në faktorë jashtëgjuhësorë ku përfshihen kushtet e komunikimit, format e komunikimit, sferat e veprimtarisë shoqërore dhe faktorët gjuhësorë ku përfshihen funksioni mbizotërues i komunikimit dhe norma ose qëndrueshmëria e gjuhës.

Përsa i përket ligjërimeve profesori merr si kriter baze faktorin gjuhësor, shkallën e ngulitjes, të përvetësimit dhe të funksionimit të normës standarte, asnjëanëse, mesatare. Ndërsa për stilet funksionale kriter baze është funksioni gjuhësor, dallues për veprimtarinë gjuhësore në një sferë të caktuar. Funksioni këtu shihet nga pikëpamja stilistike si shfaqje e përshtatjes së strukturimit ligjërimit sipas nevojave të llojeve të ndryshme të veprimtarive, që është aktualizimi i funksioneve të gjuhës në një sferë.

Për të shpjeguar sistemin, ai merr dy kriteret gjuhësore, normën N dhe funksionin F i vendos në dy boshte respektivisht vertikal dhe horizontal. Në pjesën qendrore më të gjerë dallohet norma asnjëanëse e gjuhës letrare të shkruar dhe të folur. Në dy krahet e saj të kundërt janë ligjerimi libror në pjesën e sipërme të boshtit si shkalla më e rrepte e zbatimit elastik të normës në jetën e përditshme.^x



^x Lloshi, Xhevat, *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*, SHBLU, Tirane, 2001

Më poshtë është ligjërimi i shkujdesur që del jashtë normës letrare, sepse e shkel dhe e shtrembëron atë. Dhe më tej kalojmë tek dialektet, variantet me interferenca dhe idiolekte. Sipas këtij boshti dallojmë:

a) **Leksikun e ligjërimin të thjeshtë ose “të shkujdesur”**, që përdoret nga njerëz të zakonshëm dhe të krahinave të ndryshme në rrethe të ngushta djemsh e vajzash, ku situata lejon “të shkelet etika” ose “të shtrembërohet” norma letrare. Ky leksik përfshin fjalë e shprehje me ngjyrim të theksuar emocionues (mallkime ose fjalë e shprehje) për të sharë, për të fshikulluar të metat e gabimet e dikujt, si psh.: “*ishte bërë tapë, prandaj e hekurosi makina dhe e bëri pëlte; e katranosi fare “e prishi punën a muhabetin”*; *ishte qorr* etj.

b) **Leksiku i ligjërimin bisedor** është afër me atë të ligjërimin të thjeshtë. Këtu kemi jo “shkelje”, por “lëkundje” të normës leksikore, duke u përpjekur të mos përdorim shumë fjalë jashtë etikës dhe normës letrare, për të treguar se kemi njëfarë kulturë gjuhësore. Në këtë rast, ligjërimi dhe norma leksikore nuk vihet “në pranga” a “në bunker”, nuk kyçet «me zinxhirë» kufizues; por, megjithatë, edhe në këtë rast, biseduesi ka kujdes që të mos përdorë fjalë banale, sharëse e mallkime, sikurse në ligjërimin e thjeshtë. Karakteristike për këtë ligjërim janë fjalë e shprehje të tilla, si: *bëj derman, ia bëj hallall, u gjenda bosh, mbusha plëncin, ia zbraza troç, llafe* (kundrejt fjalë), *më luajti tepeleku* (kundrejt *truri*) i kokës, *pjell* (kundrejt *lind*), *behar* (kundrejt *verë* etj.); gjithashtu, këtu përdoren më shumë pasthirma dhe fjalë onomatopeike.

c) **Leksiku i ligjërimin publik ose libror** është ai ku zbatohet më shumë se kudo norma gjuhësore. Në këtë stil përdoren më shumë terma sesa fjalë, si psh. *përparësi* e *papërgjegjshmëri, pandërgjegjshmëri, papajtueshmëri, i kundërligjshëm, dorështrënguar* (dhe jo *koprac*) etj.

Megjithatë, siç shihet, nuk ka kufij të prerë, si me thikë, për leksikun sipas ligjëriminve: *të thjeshtë, bisedor dhe libror*.

Gjithashtu profesor Xh. Lloshi për mend edhe stilin funksional ku për bazë merret përdorimit në leksik.

Sipas kësaj këtij kriteri dallohet

a) **Ligjërimin i folur**, ku vihet re se si ky leksik (që përdoret në të folur) përbëhet më shumë nga fjalë të shkurtëra (emra e folje njërrënjëshe, lidhëza ose parafjalë jo të përngjitura etj.).

b) **Ligjërimin i shkruar** ku vihet re se fjalët janë me përmasa më të gjata dhe sintaksa e fjalisë ndërtohet më shumë me emra veprimi ose abstraktë dhe kompozita në rasën gjinore, rrjedhore etj.

Krahasoni, psh.:

Ligjërimi i **folur**

s' (psh. *s' dua*)

Ligjërimi i **shkruar**

nuk (psh. *nuk dëshiroj*)

ç'	(ç' thua more!)	çfarë (psh. çfarë po thoni!)
e	<i>lidhëz</i>	dhe
ca	<i>përemër</i>	disa
që	<i>përemër</i>	i(e) cili(a)
që	<i>lidhëz</i>	me qëllim që

Në boshtin horizontal ndarja në pesë stile bëhet sipas funksionit mbizotërues:^{xi}

1. Stili i veprimtarisë letrare-artistike
(ku funksioni mbizotërues është estetik)
2. Stili i veprimtarisë shoqërore-politike
(ku funksioni ikumtimit bashkohet me atë ndikues)
3. Stili i veprimtarisë shkencore-teknike
(ku funksioni mbizotërues është kumtimi)
4. Stili i veprimtarisë shtetërore-administrative
(ku funksioni kumtimit bashkohet me atë parashikues)
5. Stili i veprimtarisë fetare
(ku funksioni mbizotërues është sugjestiv)

Sipas profesorit nderprerja e këtyre dy boshteve sjell mundësi të shumta të trajtimit të tyre si tema të caktuar në sferën e ndryshme ashtu edhe në shkallë të ndryshme të normës.

6.2 Stili i letërsisë artistike

Është gjuha e veprave të letërsisë artistike. Përveç fushës së veprimtarisë, në zgjedhjen e përdorimit të mjeteve gjuhësore ka rëndësi edhe gjinia e shkrimeve, subjekti e personazhet, epoka që pasqyrohet, botëkuptimi e formimi gjuhësor i autorit etj. *Gjuha e veprave letrare dallohet për përdorimin e fjalëve të zgjedhura, "kumbuese" dhe që "tingëllojnë bukur", fjalë të cilat shprehin më mirë ndjenjat dhe qëndrimin e autorit.* Si pasqyrim artistik i jetës, i botës, letërsia përdor shumë figurat letrare. Vlerat stilistike mund të jepen edhe me anë të mjeteve gramatikore, si me anë të prapashitesash zvogëlimi, përkëdhelie ose përbuzjeje.

Në stilin e letërsisë artistike dallohen dy variante kryesore: *ai i prozës* dhe *ai i poezisë*. Në leksikonin e tyre ka dallime:

- *Leksiku i poezisë* përfshin fjalët e poezisë popullore dhe krijimet e poetëve të brezave të mëparshëm e të tashëm. Por, sipas llojit të poezisë e të temës që trajtohet në të, mund të futen në poezi fjalë të çdo fushe. Kështu, në baladë, në poemë ose në poezi për një arritje në teknikë, për një figurë a për një ngjarje të shënuar historike etj. do të gjejmë edhe terma. Por karakteristikë e përgjithshme e leksikut poetik është mungesa e terminologjisë tekniko-shkencore, e fjalëve të huaja e krahinore, e arkaizmave etj. Ka shumë krijime poetike e shprehje popullore të bukura. Duket që fjalët zgjidhen me kujdes, si nga përmbajtja e

^{xi} Lloshi, Xhevat, Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika, SHBLU, Tirane, 2001, f.157

shprehësia, ashtu edhe nga tingëllimi. Le të vërehen këto karakteristika në vargjet e mëposhtme të Ismail Kadaresë: “Këtij qyteti s’do t’ia kërkojnë kurrë gërmadhat, / arkeologët, / kohërat s’do t’i hedhin me radhë / hi dhe pluhur mbi kokë. / I gjallë ai / me buzëqeshje të zjarrtë, / do t’i mbushë arteriet, / tymra, shkëndija, avuj, / mbi muzeumet, kohërat dhe harrimin / përjetësisht do të vjellë”.

Zgjedhja e fjalëve bëhet edhe për të shprehur urrejtje, tallje, përbuzje etj., siç ndodh në poezinë humoristike e satirike. Si këtu, edhe në lloje të tjera të poezisë, përdoren fjalë me ngjyrim emocionues të dukshëm e me shprehësi të lartë. Metafora, metonimia, sinekdoka dhe figura të tjera letrare i japin gjuhës së poezisë një bukuri karakteristike.

- *Në prozë* kemi një leksik shumë më të gjerë. Letërsia pasqyron çdo fushë të jetës. Në një roman mund të përfshihen ngjarje nga çdo fushë e veprimtarisë shoqërore, nga natyra etj. Prandaj edhe leksiku i veprave letrare është i pasur dhe i gjithanshëm. Në të përfshihen fjalë të poezisë dhe të prozës artistike, terma të degëve të ndryshme të prodhimit, leksiku i të gjitha ligjërimeve etj. Kjo varet nga tema që trajtohet. Elementet e stileve të tjera e bëjnë më të përpiktë pasqyrimin artistik. Në fjalorin e veprave artistike përfshihen fjalë me ngjyrim emocionuese-shprehëse, fjalë të zgjedhura, që mund të tipizojnë si duhet figurat artistike e mjediset shoqërore, fjalë që karakterizojnë një kohë (historizmat, arkaizmat), fjalë të ligjërit të thjeshtë e fjalë krahinore, fjalë të reja të krijuara nga autori etj.

Për shkak të gjerësisë e të mungesës së organizimit sipas një norme të vetme, ka autorë që gjuhën e letërsisë artistike nuk e marrin si stil të thjeshtë funksional, por si një tërësi stilesh e ligjërimesh të ndryshme. Gjithsesi, ligjërimi i shkrimtarit i përmbahet rregullisht standardit, kurse ligjërimi karakteristik i personazheve u përshtatet kërkesave stilistike dhe mjetet gjuhësore në këtë ligjërim jashtë standardit fitojnë vlerat e stilemave.

Leksiku i prozës letrare ndryshon sipas vetë lëndës. Ndryshe është leksiku i veprave që trajtojnë tema shkencore, ku përfshihet një numër i madh termash shkencorë-technikë, ndryshe është leksiku i veprave që trajtojnë probleme shoqërore-historike, ku përfshihen fjalë të bisedës së zakonshme, fjalë të vjetruara etj. Pastaj, leksiku i prozës poetike afron shumë me atë të poezisë; edhe ai i dramës ka veçoritë e tij. Ja një shembull nga një përshkrim letrar.

Tipare edhe më të theksuara ka leksiku i letërsisë humoristike, pasi në të përdoren më dendur disa shtresa fjalësh, si fjalët e huazuara, sidomos turqizmat, fjalët krahinore (edhe me shqiptim krahinor) e shumë njësi frazeologjike. Këtu norma stilistike ka kufi shumë të gjerë dhe leksiku pothuaj nuk ka fare kufizime nga ana kohore, krahinore, profesionale etj. Në përgjithësi leksiku i letërsisë artistike *dallohet për funksionin e dyfishtë*: fjala aty mund të përdoret me kuptim të drejtpërdrejtë dhe me kuptim të figurshëm, gjë që nuk është karakteristikë, fjala vjen, për letërsinë shkencore.

6.3 Stili politiko-shoqëror^{xii}

Është gjuha e veprave politiko-shoqërore, e gazetës, e propagandës, e raporteve, e fjalimeve, e bisedave politike dhe e artikujve të kësaj fushe. Nga ana leksikore ky stil qëndron ndërmjet atij të letërsisë artistike dhe atij shkencor-teknik. Letërsia politiko-shoqërore ka një leksik të zgjedhur, me terminologji të gjerë, me fjalë me kuptim kryesisht të drejtpërdrejtë. Sikurse letërsia artistike, ka edhe fjalë me kuptime të figurshme, disa fjalë të vjetruara a dialektore, që përdoren sipas rastit, frazeologji popullore etj.

Stili i sotëm politiko-shoqëror në gjuhën tonë ka nisur të kristalizohet më herët, që me publicistikën e Rilindjes Kombëtare. Ky stil u kristalizua shumë shpejt dhe, së bashku me stilin e letërsisë artistike, ka luajtur rol të dorës së parë në njësimin e gjuhës standarde, në ngulitjen e normave dhe veçanërisht në pasurimin e saj me mjete shumëvlerëshe. Ai është zhvilluar në dy variante kryesore: në variantin e veprave, të referateve, të fjalimeve etj. me karakter politik e shoqëror dhe në variantin e publicistikës (të gazetës e të revistës dhe të medias së folur). Në të dy variantet hyjnë shumë gjini, që nga informacioni i thjeshtë e artikulli i gazetës e deri te raportet e veprat politiko-shoqërore të letrarizuara, deri te përshkrimi, te reportazhi, te portretizimi artistik, te kujtimet (memualet) etj. Një tipar themelor, pra, i stilit të sotëm politiko-shoqëror është *gjerësia e madhe tematike e gjinore, që nga kufijtë e shkencës deri te letërsia artistike*. Ky tipar ka përcaktuar edhe një dukuri tjetër: shpërthehen kufijtë e një stili të ngrirë e vërshojnë në të mjete të shprehjes nga stilet e tjera e nga ligjërimet e ndryshme, madje edhe nga ligjërimi i thjeshtë.

Një tipar tjetër themelor i leksikut të këtij stili sot është *pasuria e madhe me fjalë e shprehje të ligjërimeve popullore, pra, mbështetja në ligjërimet e folura popullore*. Kjo jep mundësi që të zhvillohet një stil i pasur e i larmishëm dhe me fuqi të madhe ndikuese. Vala e huazimeve të panevojshme, që erdhi në dhjetëvjeçarin e fundit të shekullit XX dhe në këto vite të shekullit të ri, pjesërisht do të qëndrojë e pjesërisht do të jetë kalimtare e kështu ajo mund të prekë e mund të prishë diçka në këtë stil, por nuk do t'ia ndryshojë tiparet themelore.

6.4 Stili shkencor-teknik^{xiii}

Është gjuha e veprave, e artikujve dhe e studimeve shkencore, si edhe gjuha e veprimtarisë shkencore e teknike, e prodhimit etj. Një *karakteristikë e përgjithshme e leksikut të prozës shkencore është pasuria me terma nga fusha të ndryshme të diturisë*. Kur lexojmë një studim a një traktat shkencor për mjekësi, për industri, për gjuhësi, për art etj. na bien në sy në radhë të parë termat. Në gjuhën e veprave shkencore e të veprimtarisë teknike ka terma të ndërtuar

^{xii} Lloshi, Xhevat, Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika, SHBLU, Tirane, 2001, f. 217

^{xiii} Lloshi, Xhevat, Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika, SHBLU, Tirane, 2001, f. 190

me brumin e shqipes, që emërtojnë sende e pjesë të tyre, veprime e cilësi etj. Kjo pjesë e terminologjisë sa vjen e rritet, ngulitet dhe mbizotëron në çdo fushë të shkencës.

Nga ana tjetër, kërkohet domosdo një përpjekje e vetëdijshme dhe e vazhdueshme *për të mënjeluar përdorimin pa nevojë e me tepri të termave e të fjalëve të huaja, që krijojnë vështirësi për të kuptuar përmbajtjen e tekstit*. Puna që bëhet për pastrimin e shqipërimin e terminologjisë, përkrahet e përhapet në të gjitha fushat dhe kjo do ta mënjanojë “intelektualizmin” në gjuhë, që del hera-herës në disa vepra e studime shkencore.

Në prozën shkencore është karakteristik përdorimi i gjerë i emrave foljorë prapashtesorë me *-im* dhe *-je*, përdorimi i një vargu emrash në rasën gjinore, i lokucioneve të reja librore etj. Këtu ndeshemi me togje të tilla, si: ushtron ndikimin, hyn në lidhje, në fakt, në esencë, në krahasim me, për shkak se etj. Dendur përdoren ndajfoljet me prapashtesën *-isht* (*gjerësisht, parimisht, përfundimisht* etj.), trajtat pavetore të foljeve (*dihet, duhet, kapet, kërkohet, lejohet* etj.) dhe foljet e gjendjes, të të menduarit etj. (*gjendet, pranoj, varet, vërej* etj.).

Në këtë stil fjalët *përdoren me kuptim të drejtpërdrejtë; fjalët me kuptime të figurshme ose figurat letrare janë të rralla*. Edhe frazeologjia nuk zë vend të rëndësishëm. Leksiku i veprave shkencore është i pastër nga fjalët e vjetruara, nga turqizmat, nga fjalët krahinore, nga fjalët e të folmeve shoqërore dhe përgjithësisht nga mjetet e ligjërimit të thjeshtë e bisedor.

Në stilin shkencor mjetet leksikore zgjidhen me kujdes, me synimin që mendimet të shprehen me qartësi e përpikëri të madhe. Ato mund të ndahen në dy shtresa: shtresa leksikore e përdorimit të përgjithshëm dhe shtresa e kufizuar nga pikëpamja profesionale, në të cilën vendin kryesor e zë terminologjia.

6.5 Stili shtetror-administrativ^{xiv}

Në këtë stil hartohen shkresat e dokumentet zyrtare, lutjet, telegramet, ligjet e vendimet gjyqësore, kushtetutat e statutet, rregulloret, urdhëresat, lejet, përhëndetjet etj. Leksiku i këtij stili është më i kufizuar se në stilet e tjera, fjalët gjithmonë përdoren me kuptim të drejtpërdrejtë, nuk ndërtohen figura letrare, ka terma, fjalë të huaja e ndërkombëtare. Në letërsinë e këtij lloji nuk gjejmë fjalë të vjetruara e krahinore. Shenjë e dukshme e këtij stili, janë edhe *disa lokucione lidhëzore e parafjalore*, disa togje fjalësh dhe disa shprehje të ligjërimit libror, që, nga përsëritja e dendur dhe e vazhdueshme, janë kthyer në formula ose në elemente tipike gjuhësore (*duke qenë se, duke marrë parasysh se, në drejtim (të), si rrjedhim, është rregull që, në bazë të ligjit, sipas nenit, në emrin tim, kam nderin të parashtroj, i drejtohem asaj ministrie, shpresoj që lutja do të merret parasysh, me nderime, ju njoftojmë që* etj.).

Me gjithë karakterin e tij përgjithësisht më të ngurosur, edhe ky stil ka pësuar ndryshime e zhvillime, duke u çliruar nga disa fjalë, shprehje e ndërtime të vjetruara, nga

^{xiv} Lloshi, Xhevat, Stilistika e gjuhes shqipe dhe pragmatika, SHBLU, Tirane, 2001, f. 203

disa kallëpe burokratike e duke u bërë më i zhdërvjellët, si në leksik edhe në sintaksë. Kështu, në shumë dokumente po hyn fjala kërkesë në vend të lutje, shprehjet përshëndetje në vend të me nderime, në emrin tim në vend të në emrin tim personal etj.; fraza është përpunuar dhe është afruar më shumë me atë të stileve të tjera. Pra, krahas përvijimit e kristalizimit të këtij stili, po bëhet edhe ndarja e mjeteve gjuhësore. Nga njëra anë, shtohen elementet e leksikut të përgjithshëm që hyjnë në këtë stil si mjete asnjëse, të përbashkëta për të gjitha stilet dhe përpunohet kështu stili si një pjesë e gjuhës standarde, si edhe afrohet me stilet e tjera; nga ana tjetër, shquhen më qartë mjetet gjuhësore me vlerë stilistike që karakterizojnë këtë stil. Në këtë mënyrë bëhen më të dallueshëm kufijtë e këtij stili me stilet e tjera. Të dyja këto dukuri janë pjesë e zhvillimit të stilit funksional. Ky zhvillim lidhet si me zhvillimin e gjuhës standarde në përgjithësi, ashtu edhe me luftën që bëhet për ta pastruar gjuhën e shkresave zyrtare nga fjalët e shprehjet, të cilave tashmë u ka kaluar koha.

6.6 Stili fetar

Në këtë stil hartohen veprat fetare.^{xv}

7. Përfundime

a. Ngjashmëritë

Rezultatet e krahasimit të klasifikimit në gjuhën angleze dhe shqipe rezultojnë se ka disa të përbashkëta dhe dallime. Mund të themi që **stili Shkecor** i I. Galparinit ka karakteristika të njëjta me atë **Shkencor-Teknik** të Xh. Lloshit. Gjithashtu ngjashmëri vërehet ndërmjet **stilit të Dokumentave zyrtare** të I. Galparinit dhe stilit **Shtetëror-administrativ** të Xh. Lloshit. **Stili Politik-Shoqëror** i pranishëm në klasifikimin e Xh. Lloshit ka të përbashkëta me dy stile të I. Galparinit, me atë të **Publicistikës dhe stilit Gazetaresk**. Gjithashtu dhe **stili Letrar** ka të përbashkëta në dy klasifikimet. Dallimi i vetëm për sa i përket këtij të fundit është se Galparini e ndan këtë stil në **stilin e poezisë, prozës dhe dramës**, ndërsa Xh. Lloshi e ndan në **stilin e poezisë dhe të prozës**.

b. Dallimet

Një ndër dallimet ndërmjet dy klasifikimeve është **stili Fetar** i cili nuk është i pranishëm në klasifikimin I. Galparinit. Gjithashtu Xh. Lloshi bën edhe një ndarje tjetër ku përdor kriterin e përdorimit dhe dallon **ligjërimin e folur e të shkruar** si dhe kriterin e përdorimit të leksikut sipas situatave të ligjërimin ku dallon: **Leksikun e ligjërimin të thjeshtë ose "të shkujdesur, Leksiku i ligjërimin bisedor, Leksiku i ligjërimin publik ose libror**. Këto stile nuk janë të pranishme në klasifikimin e I. Galparinit, por përmenden në dy klasifikimet e dy studjuesve të tjerë, I. Arnoldit dhe J. Skrebnevit.

^{xv} Lloshi, Xhevat, Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika, SHBLU, Tirane, 2001, f. 157

Duhet përmendur fakti se stilet funksionale nuk kanë një kufij të qartë ndërmjet tyre dhe nuk mund të ndahen me thikë.

Thelbi i zhvillimit të çdo stili është zgjedhja dhe përdorimi i mjeteve nga thesari i gjuhës, në përputhje me kërkesat e përmbajtjen e një fushe të caktuar. Prandaj, sikurse për gjuhën standarde, edhe për stilet veças, puna e kujdesshme dhe e ndërgjegjshme e shkrimtarit, e shkencëtarit, e gazetarit, e mësuesit, e nëpunësit dhe e kujt do tjetër që flet e shkruan një gjuhë të caktuar, është e dobishme në radhë të parë për vetë kristalizimin e zhvillimin e mëtejshëm të stileve.

Stilet nuk tregojnë “copëzimin” ose “dobësimin” e standardit, përkundrazi, ato janë shprehje e përsosjes, e zgjerimit të funksioneve shoqërore, e rritjes së aftësive dhe e vlerave të gjuhës.

Nga ana tjetër, në çdo stil duhet të shfrytëzohet si norma stilistike, ashtu edhe norma gjuhësore në tërësi, duhet të vihen në përdorim sa më shumë mjete të gjuhës në përgjithësi, përndryshe stili do të mbetet anemik, i thatë, pa forcë të brendshme. Me zgjerimin e funksioneve shoqërore të gjuhës standarde, si dhe me zhvillimin e vetë gjuhës standarde, ecën edhe kristalizimi e përsosja e mëtejshme e stileve funksionale të një gjuhe.

Studimi i stileve të gjuhës, i mjeteve stilistike dhe i përdorimit të tyre ka edhe rëndësi praktike, sepse ndihmon çdo njeri që shkruan, të ruajë veçoritë e stilit, të cilit i përket shkrimi i tij.

Bibliografia

Arnold V.I., (1986) *The English Word*. By Moscow: Vyssaja Skola

Galperin I.R., (2004) *Practical Stylistic of English*.

Lloshi, Xhevat, *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*, SHBLU, Tirane, 2001, f. 157

Skrebnev Y.M., (2003) *Fundamentals of English Stylistics*, By AST

Creative Commons licensing terms

Author(s) will retain the copyright of their published articles agreeing that a Creative Commons Attribution 4.0 International License (CC BY 4.0) terms will be applied to their work. Under the terms of this license, no permission is required from the author(s) or publisher for members of the community to copy, distribute, transmit or adapt the article content, providing a proper, prominent and unambiguous attribution to the authors in a manner that makes clear that the materials are being reused under permission of a Creative Commons License. Views, opinions and conclusions expressed in this research article are views, opinions and conclusions of the author(s). and European Journal of Literature, Language and Linguistics Studies shall not be responsible or answerable for any loss, damage or liability caused in relation to/arising out of conflicts of interest, copyright violations and inappropriate or inaccurate use of any kind content related or integrated into the research work. All the published works are meeting the Open Access Publishing requirements and can be freely accessed, shared, modified, distributed and used in educational, commercial and non-commercial purposes under a [Creative Commons Attribution 4.0 International License \(CC BY 4.0\)](https://creativecommons.org/licenses/by/4.0/).